



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:078505
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05621845

PA1.nr.985/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti- kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.K, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1, nënpar.1.1 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të KPPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit A.K, av. A.A të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.2225/23 të dt. 14.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 24.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit A.K, av. A.A, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.2225/23 të dt. 14.06.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin, P.nr.2225/23 të dt. 14.06.2023, të akuzuarin A.K e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1, nënpar.1.1 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të KPPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej

1(një) viti, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi dhe dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj ne afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit. Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me gjobë zëvendësohet me dënimin me burgim, 20 (njëzet) euro gjobë llogaritet barabartë me 1 (një) ditë burgim. Koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës 28.03.2023 e deri me datë 14.06.2023, do të llogaritet ne dënimin e shqiptuar. Obligohet i pandehuri që të paguaj ne emër të shpenzimeve të procedurës penale paushallin gjyqësor ne shumë prej 30 (tridhjetë) euro, kurse në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

Të akuzuarit i konfiskohet: Arma e tipit “ Zoraki -M”, 906-B dhe një karikator, konform nenit 366 par. 3 të KPP-së.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit A.K, av. A.A, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe shpenzimeve të procedurës penale , me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës të miratoj ankesën, me ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar, duke e liruar të akuzuarin A.K, nga pjesa e dënimin me gjobë, dhe nga vendimi për pagimin e shpenzimeve të procedurës penale.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1021/23 të datës 09.08.2023, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.K, av. A.A e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal dhe shpenzimeve të procedurës penale , me pretendimet se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar, në pjesën e shqiptimit të vendimit lidhur me sanksionin penal sa i përket dënimin me gjobë , si dhe pjesës së vendimit lidhur me shpenzimet e procedurës penale, me rastin e shqiptimit të këtij vendimi gjykata nuk i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat përkatëse dhe përkundër mos tejkalimit të kompetencave ligjore nuk e ka caktuar drejt sanksionin penal, pra, në këtë rast dënimin me gjobë prej 400 (katërqind) euro, ndaj të pandehurit A.K. Po ashtu, gjykata vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës penale është në kundërshtim me vetvete dhe me arsyetimin në raport me të mbrojturin tim; në aktgjykim në pjesën e ankimuar edhe pse gjykata i ka cekur dispozitat ligjore në të cilat e ka mbështetur shqiptimin e dënimin me gjobë, pra dispozitat nga neni 69 par.5 të KPRK-së dhe nenet 449, 451 të KPP-së, prapë se prapë nuk e ka bërë vlerësimin e drejtë dhe e ka shqiptuar vendimin jo të

drejtë sepse shqiptimi i dënimit me gjobë për të pandehurin A.K është jo i drejtë për arsye se i njëjti në bazë të Ekzaminimit psikiatrik i realizuar në Institutin e Psikiatrisë Forenzike, të datës 28.04.2023, është konstatuar diagnoza çrregullim i personalitetit- i paspecifikuar që në Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve kodohet me F 60.9 (ICD) që do të thotë se me vet faktin se i pandehuri A vuan nga ky çrregullim, si dhe i njëjti është i papunë, me gjendje të dobët ekonomike dhe nuk ka mundësi që të bëjë pagesën e dënimit me gjobë dhe vendimit lidhur me shpenzimet e procedurës penale sepse ky lloj çrregullimi ja pamundëson që ky të jetë i aftë që vet të kujdeset për veten si dhe të punoj e aq më pak që me punën e tij të krijoj mjete dhe të mira materiale për jetesë të dinjitetshme. Andaj, mbrojtja me të drejtë konsideron se vendimi mbi dënimin me gjobë dhe ai lidhur me shpenzimet e procedurës penale është jo i drejtë dhe i pa analizuar mirë. Nga Gjykata nuk është bërë vlerësimi i drejtë i këtyre rrethanave , e që në rastin konkret siç janë; gjendja shëndetësore dhe ajo pasurore, mandej shumica e të ardhurave personale, si dhe të ardhurat e tjera, e në rastin konkret këto po thuajse nuk ekzistojnë sepse i pandehuri A jeton me ndihma që ia dërgojnë, jo rregullisht vëllezërit dhe motrat. Pra, siç mund të shihet, nga elaborimi i këtyre fakteve, rrethanave dhe kushtet në të cilat jeton i mbrojturi , pothuajse e ka të pamundur që të bëjë pagesën e dënimit me gjobë dhe të shpenzimeve të procedurës penale. Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit nuk i ka vlerësuar drejtë këto rrethana, andaj vendimi është jo i drejtë. I propozon Gjykatës e Apelit e Kosovës që të miratoj ankesën, me ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar, duke e liruar të akuzuarin A.K, nga pjesa e dënimit me gjobë , dhe nga vendimi për pagimin e shpenzimeve të procedurës penale.

Edhe pse nuk është parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispoziave të procedurës penale Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës në pajtim me nenin 394 të KPPRK e vlerësoj sipas detyrës zyrtare aktgjykimin e ankimuar në këtë drejtim dhe konstatoj se aktgjykimi në fjalë nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësi të të akuzuarit, që i akuzuari të lirohet nga pjesa e dënimit me gjobë dhe nga shpenzimet e procedurës penale, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme e cila do ta arsyetonte lirimin nga dënimi me gjobë dhe shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarin. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ku si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi, se i pandehuri A.K e ka pranuar fajësinë në tërësi për veprat penale për të cilën akuzohet në seancën e shqyrtimit fillestar, se ndjen keqardhje për veprën penale të cilat i ka kryer, i ka kërkuar falje palës së dëmtuar në prezencë të gjykatës, i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërisë më vepra penale në të ardhmen, pëndesën e thellë të kryerësit për kryerjen e veprës penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata vlerësojë të mirën juridike të mbrojtur me dispozitat penalo juridike.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë

të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit, nuk kanë ndikim që të akuzuarin ta liroi nga dënimi me gjobë dhe shpenzimet e procedurës penale. Të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.985/23, më datë 24.04.2024

Procesmbajtësja,
Gentijana Manaj-Gashi

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Abdullah Ahmeti

Ferit Osmani
